



REPUBLIKA E SHQIPERISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E THESARIT
DREJTORIA E KONTABILITETIT DHE RAPORTIMIT FINANCIAR

Nr. 10253/... Prot.

Tirane... 9/10/2009

URDHËR

Nr. 79 datë 9/10/2009

**PËR SHPALLJEN E NDRYSHIMEVE NË STANDARDËD
NDËRKOMBËTARE TË KONTABILITETIT DHE TË RAPORTIMIT
FINANCIAR, TË PËRKTHYER NË GJUHËN SHQIPE.**

Në mbështetje të nenit 4, pika 3, të ligjit nr.9228, datë 29.04.2004 « Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare », i ndryshuar, në vendimin nr.5 datë 15.09.2009 të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, “Për miratimin e Ndryshimeve të SNK dhe SNRF për vitin 2007” të cilat hyjnë në zbatim në vitin 2009, të përkthyer në gjuhën shqipe nën përgjegjësinë e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit dhe pa u ndryshuar nga teksti origjinal në gjuhën angleze, sipas materialeve bashkëngjitur:

U R D H Ë R O J

Shpalljen e ndryshimeve në:

1. Standardin Ndërkombëtar të Raportimit Financiar (SNRF) 1, “Adoptimi për herë të parë i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar”.
2. Standardin Ndërkombëtar të Kontabilitetit (SNK) 27 “Pasqyrat financiare të konsoliduara dhe individuale” (të ndryshuar prej përmirësimeve në SNRF-të në Maj 2008)
3. SNRF-të e tjera
 - a. SNK 18, “Të ardhurat”
 - b. SNK 21, “Efektet e ndryshimeve në kurset e këmbimit të monedhave të huaja”
 - c. SNK 36, “Zhvlerësimi i aktiveve”
4. Standardin Ndërkombëtar të Raportimit Financiar (SNRF) 5, “Aktive afatgjatë të mbajtura për t’u shitur dhe operacionet e ndërprera”
 - a. Shtojcë e Ndryshimeve në SNRF 5
 - i. Ndryshime në SNRF 1, “Zbatimi për herë të parë i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar”
5. Standardin Ndërkombëtar të Kontabilitetit SNK 1, “Paraqitja e pasqyrave financiare (i rishikuar në 2007)”.
6. Standardin Ndërkombëtar të Kontabilitetit SNK 16, “Aktivet afatgjata materiale”

- a. Shtojcë e ndryshimeve në SNK 16
 - i. Ndryshime në SNK 7, “Pasqyra e rrjedhjes së parasë”.
- 7. Standardin Ndërkombëtar të Kontabilitetit SNK 19, “Përfitimet e punonjësve”
- 8. Standardin Ndërkombëtar të Kontabilitetit SNK 20, “Kontabiliteti i granteve dhe dhënia e informacioneve shpjeguese për ndihmën qeveritare”.
- 9. Standardin Ndërkombëtar të Kontabilitetit SNK 23, “Kostot e huamarrjes” (rishikuar në 2007).
- 10. Standardin Ndërkombëtar të Kontabilitetit SNK 27, “Pasqyrat financiare të konsoliduara dhe individuale” (i ndryshuar në Janar 2008).
- 11. Standardin Ndërkombëtar të Kontabilitetit SNK 32, “Instrumentat financiarë: ”Paraqitja”
- 12. Standardin Ndërkombëtar të Kontabilitetit SNK 1, “Paraqitja e pasqyrave financiare” (rishikuar në 2007).
- a. Ndryshimet në SNRF 7, SNK 39 dhe KIRFN 2
 - i. SNRF 7 Instrumentat financiarë: “Paraqitja “
 - ii. SNK 39 Instrumentat financiarë: “Njohja dhe matja”
 - iii. KIRFN 2 “Pjesët (aksionet) e anëtarëve në njësitë ekonomike të përbashkëta dhe instrumentat e ngjashëm”
- 13. Standardin Ndërkombëtar të Raportimit Financiar SNRF 3, dhe SNK 27, të ndryshuar.
- 14. Standardin Ndërkombëtar të Kontabilitetit SNK 28 ”Investimet në pjesëmarrje”.
- 15. Standardin Ndërkombëtar të Kontabilitetit SNK 29,” Raportimi financiar në ekonomitë me hiperinflacion”.
- 16. Standardin Ndërkombëtar të Kontabilitetit SNK 36, “Zhvlerësim i aktiveve”
- 17. Standardin Ndërkombëtar të Kontabilitetit SNK 38, “Zhvlerësim i aktiveve jomateriale”.
- 18. Standardin Ndërkombëtar të Kontabilitetit SNK 39, Instrumentat Financiarë: “Njohja dhe matja”
 - a. Ndryshimet në udhëzimin e zbatimit të SNK 39, Instrumentat financiarë: “Njohja dhe matja”.
- 19. Standardin Ndërkombëtar të Kontabilitetit SNK 40, “Aktiv afatgjatë material i investuar “.
- 20. Shtojcë për ndryshimin në Standardin Ndërkombëtar të Kontabilitetit SNK 40,
 - a. Ndryshimi i SNK 16, “Toka, ndërtesat, makineritë dhe pajisjet”
- 21. Standardin Ndërkombëtar të Kontabilitetit SNK 41, “Bujqësia”
- 22. Standardin Ndërkombëtar të Kontabilitetit SNK 8, “Politikat kontabël, ndryshimet në politikat kontabël dhe gabimet”
- 23. Standardin Ndërkombëtar të Kontabilitetit SNK 10, “Ngjarjet pas periudhës së raportimit”
- 24. Shtojcën e Standardid Ndërkombëtar të Kontabilitetit SNK 18, “Të ardhurat”.
- 25. Standardin Ndërkombëtar të Kontabilitetit SNK 20, “Grantet qeveritare dhe dhënia e informacioneve shpjeguese për ndihmën qeveritare”.
- 26. Shtojcë për ndryshimin e Standardid Ndërkombëtar të Kontabilitetit SNK 20,
 - a. Ndryshimi i SNK 41, “Bujqësia”
- 27. Standardin Ndërkombëtar të Kontabilitetit SNK 29, “Raportimi financiar në ekonomitë me hiperinflacion”.
- 28. Standardin Ndërkombëtar të Kontabilitetit SNK 34, “Raportimi financiar i përkohshëm”.

29. Standardin Ndërkombëtar të Kontabilitetit SNK 40, "Aktiv afatgjatë material i investuar".
30. Standardin Ndërkombëtar të Kontabilitetit SNK 41, "Bujqësia".
31. Shtojcë për ndryshimet në Standardin Ndërkombëtar të Kontabilitetit SNK 41,
- a. Ndryshime në SNRF të tjera
 - i. SNRF 5, "Aktivet jofinanciare të mbajtura për shitje dhe veprime të ndërprera"
 - ii. SNK 2, "Inventarët"
 - iii. SNK 36, "Zhvlerësimi i Aktiveve"
32. Standardin Ndërkombëtar të Kontabilitetit SNK 31, "Interesat në sipërmarrjet e përbashkëta".
33. Shtojcë për ndryshimet në SNK 28 dhe SNK 31
- a. Ndryshimet në SNRF-të e tjera
 - i. SNRF 7 Instrumentet financiare, "Dhënia e informacionit shpjegues"
 - ii. SNK 32 Instrumentet financiare: "Paraqitja"
34. KNIRF Interpretimi 15, " Marrëveshjet për ndërtimin e pasurive të paluajtshme".
35. KNIRF Interpretimi 16, " Mbrojtja e një investimi neto në një operacion të huaj".
36. Korrigjime të botimit të vitit 2008 të datës 4 Korrik 2008, në skedarët zyrtare

Standardet bëhen të detyrueshme për zbatim nga data efektive e kalimit e shprehur në Standard. Ato publikohen në fletoren zyrtare, faqen e internetit të Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit dhe të Ministrisë së Financave

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR

Ridvan BODE